

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE për Muajin Prill 2022

Përshkrimi i Projektit:

- Projekti është pjesë e Linjës 10 që lidh rrjetin hekurudhor të Kosovës me atë rajonal dhe rrjetin evropian përmes Korridorit VIII dhe Korridorit X në Maqedoninë e Veriut. Kjo rrugë krijon një lidhje hekurudhore Beograd-Llapove-Kraljevë (në Serbi) - Fushë Kosovë - Shkup (Maqedonia e Veriut) që shkon paralelisht me Korridorin X hekurudhor
- Financimi i Projektit bëhet nga tre burime të ndryshme (BERZH, BEI/MMPLHI dhe grantit nga WBIF)
- Projekti do të sigurojë të ardhmen afatgjatë të linjës, duke rritur gjithashtu sigurinë në trafik dhe duke lejuar përmirësime në shpejtësinë aktuale të funksionimit. Shpejtësia e projektuar është 120 km/h (70 km/h për 21 km të fundit)
- Inxhinieri lëshoi Njoftimin e Fillimit të Punimeve sipas SC 8.1 më 30 gusht 2019
- Shtojca nr.3 është nënshkruar më 08/12/2021 që rregullon të gjitha çështjet kontraktuale të pazgjidhura (kërkesat dhe mosmarrëveshjet) për arritjen e përfundimit të punimeve brenda buxhetit dhe duke caktuar një datë të re përfundimi në 30/12/2022 (zgjatja e kohës me 488 ditë) pa kosto shtesë për Punëdhënësin

Statusi Kontraktual dhe Progresi i punimeve:

- Vlera aktuale e kohës së kaluar të projektit është 80%
 - Progresi Fizik aktual I Linjë Kryesore arrin 54.5%, 43.391 km të linjës janë instaluar nga 79.57 km gjithsej në total
 - Absorbimi financiar aktual I Projektit 37.7%
 - Vonesa ndërmjet progresit financiar dhe atij fizik është për shkak të materialeve të superstrukturës, të cilat përfaqësojnë 48% të kostos totale të projektit. 72.7% e këtyre materialeve janë në vend
 - Vlera aktuale e Materialeve të Linjës në punishte është 82.2%
 - Më 19/01/2022 u miratua Programi Bazë i ri i Punës
 - Nga pesë (5) Ndaletat gjithsej, tri (3) janë kompletuar me mungesë të instalimit të rrethojave kulluese dhe dysHEMEVE industriale
 - Nga gjashtë (6) tunele gjithsej, punimet në dy (2) prej tyre janë në progres; Tuneli 6 dhe Tuneli 7.
 - Rikonstruktimi i urave metalike do të fillojë së shpejti
 - Të gjitha punët civile kryhen nga fuqia punëtore vendore me mbi 250 persona të përfshirë
 - Punëdhënësi është koordinuar me Ministrinë e Mbrojtjes dhe ka siguruar mbështetjen e Qendrës së Veprimit ndaj Minave dhe njësive speciale të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)
-

për aksionet e nevojshme për praninë e mundshme të UXO/UXB/MERW në të gjithë Punishten, duke filluar me 500 m në jug të lagjes Marigona LC6 në km 255+230

Disponueshmëria e çmimit të ri të kontratës dhe shumave të përkohshme pas nënshkrimit të Adendumit (Aneksit) nr.3 është si më poshtë:

- Çmimi i ri i Kontratës pas Adendumit nr.3, do të jetë : **77,074,006.88 €**
- Shuma e kontigjente e mbetur (në dispozicion) është : **1,551,632.52 €**

Punimet e kryera janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Pjesa / Stacioni	Fillimi	Fundi	Gjatësia (m)	Përshkrimi i punëve të kryera
1	Fillimi-FK	246+888	248+200	1,312	E përfunduar, mungojnë rrethojat dhe drenazhimi
2	Stacioni i FK	248+200	249+600	1,400	E përfunduar, mungon instalimi i ndërrueseve të reja
3	FK - Miradi	249+600	250+725	1,125	E përfunduar, mungon drenazhimi, rrethojat
4	Stacioni i Miradisë	250+725	252+723	1,998	E përfunduar, mungon instalimi i plotë i ndërrueseve të reja, drenazhimi, rrethojave dhe dyshemesë së platformës
5	Miradi-Lipjan	252+723	261+338	8,615	E përfunduar, mungon drenazhimi, rrethojat
6	Stacioni Lipjanit	261+338	262+282	944	E përfunduar, mungon linja e tretë dytësore, instalimi i ndërrueseve të reja, drenazhimi, rrethojave dhe dyshemeja e platformës
7	Lipjan-Bablak	262+282	270+859	8,577	E përfunduar, mungon instalimi i plotë i ndërrueseve të reja, drenazhimit dhe rrethojave
8	Stacioni i Bablakut	270+859	271+606	746	Në progres, mungon linja kryesore dhe një dytësore, mungojnë ndërrueseve të reja, drenazhimi, rrethojave dhe dyshemesë së platformës
9	Bablak - Ferizaj	271+606	280+731	9,126	E përfunduar, mungon instalimi i drenazhimit dhe rrethojat
10	Stacioni i Ferizajt	280+731	281+937	1,205	Në progres, mungojnë dy linja dytësore të trasesë, ndërrueseve të reja, gardhe dhe dyshemeja e platformës
11	Ferizaj - Gurëz	281+937	288+994	7,057	Në progres, mungojnë 1.8 km, drenazhimi dhe rrethojat
12	Stacioni i Gurëzës	288+994	289+778	784	E përfunduar, mungon drenazhimi, rrethojat dhe dyshemeja e platformës
13	Gurëz - Kacanik	289+778	299+740	9,962	E ekzekutuar 1.2 km, mungon 7.7 km linja e trasesë, drenazhimi dhe rrethojat
14	Stacioni i Kaçanikut	299+740	300+608	868	-
15	Kacanik - HiE	300+608	311+174	10,566	Punimet në progres, 600m të realizuara
16	Stacioni i	311+174	311+954	781	Punimet në progres

Nr	Pjesa / Stacioni	Fillimi	Fundi	Gjatësia (m)	Përshkrimi i punëve të kryera
	Hanit të Elezit				
17	HiE - Fund	311+954	313+711	1,756	Punimet në progres
Gjatësia Totale =				66,823	

Kontraktori ka sjellë traversa të betonit të paranderë me gjatësi 2.60 m dhe 2.40 m (së bashku me sistemin e fiksimit tashmë të montuar/instaluar) në një numër total prej 127,326 copë (104,380 dhe 22,946), copë që përfaqësojnë 98.00% të sasisë totale.

Nga gjithsej 73, ndërruese të të dy llojeve (UIC 60 dhe S-49), 31 copë të kompletuara janë dorëzuar në total dhe janë të vendosura në zonën e stacionit Miradi.

Ura e ndërtuar	Vendosja e traversave, Gurëz-Metalurgjia
	
Ndërtimi i Shtresës së Sipërme Mbrojtëse H.i Elezit	Konstruimi i Urës
	
Shtruarja i shtresës së parë të çakëllit të ri	Ndërtimi i Linjës Hekurudhore, Stacioni Gurëz



Ndërtimi i lëshesës gypore



Hekurudha e Hapur, Bablak-Ferizaj



Testimi i Ndërruesëve, Stacioni Miradi



Instalimi i armaturës i Lëshesës



Punime të përhershme hekurudhore, Stacioni Lipjan	Ndërtimi i Shtresës së Parë të çakëllit, Gurez- Metalurgjia
	

Me shumë Respekt,

Zijadin Isufi
Udhëheqës i NjIP-PIU